UDHËZUES PRAKTIK PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT EDUKATIV INDIVIDUAL (PEI)

Save the Children

Save the Children

UDHËZUES PRAKTIK

PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT EDUKATIV INDIVIDUAL (PEI)

2017

Ky udhëzues mundësohet nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe zbatohet nga Save the Children në partneritet me shoqatën "Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara" (MEDPAK) dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS)

Manuali është vlerësuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit .

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit për zhvillim politikash dhe praktikasharsimore, prej mësuesve dhe jo vetëm, por jo për qëllime fitimprurëse, pa patur nevojë për të marrë leje më parë nga "Save the Children", por në çdo rast duke cituar burimin, nga i cili janë marrë.

Këndvështrimet e autorëve të këtij publikimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

Autorë:
Msc. Dhurata Nixha, Save the Children, Shqipëri
Msc. Olger Brame, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
Msc. Arjan Kamburi, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
Prof. as dr. Ardjan Turku, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
Prof. as. dr. Valentina Haxhiymeri, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

Redaktor shkencor: Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA

Redaktor gjuhësor: MSc. Olger Brame

PËRMBAJTJA

SHKURTIME 4

HYRJE 5

RËNDËSIA E PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA 5

SFONDI I TË DREJTAVE 6

TË DREJTAT E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR1 NË KUADRIN LIGJOR SHQIPTAR 6

SI TA PËRDORIM KËTË UDHËZUES 9

SHPJEGIM KONCEPTESH 10

ÇFARË ËSHTË NJË PLAN EDUKIMI INDIVIDUAL (PEI) 13

KUR HARTOHET DHE PSE ËSHTË E RËNDËSISHME NDJEKJA E FËMIJËS ME PEI 14

SI GËRSHETOHET PLANI EDUKATIV INDIVIDUAL ME KURRIKULËN SHKOLLORE? 14

CILAT JANË HAPAT KRYESORE NË NDËRTIMIN E PEI-t 15

KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR HARTIMIN E PEI-T? 16

PJESA A: TË DHËNA PËR NXËNËSIN DHE PROFILI DINAMIK FUNKSIONAL I TIJ 17

A.1. TË DHËNA DEMOGRAFIKE TË NXËNËSIT 17

A.2. ARSYEJA PËR HARTIMIN E PEI-T 17

A.3. HISTORIKU DHE ASISTENCA SHËNDETËSORE 18

A.3.1. INFORMACION MBI VLERËSIMIN E TË DHËNAVE DHE PËRVOJËN E VITEVE TË FUNDIT 18

A.3.2. LLOJET E SHËRBIMEVE TERAPEUTIKE QË NXËNËSI KA MARRË 18

A.3.3. GJENDJA AKTUALE SHËNDETËSORE E NXËNËSIT 18

A.4. PROFILI DINAMIK FUNKSIONAL (PDF) 19

PJESA B: PLANI EDUKATIV INDIVIDUAL (PEI) 21

B.1. ZHVILLIMI I NXËNËSIT NË FUSHA SPECIFIKE 21

B.2. REZULTATET E PRITSHME TË FËMIJËS/NXËNËSIT, BAZUAR NË FUSHAT E ZHVILLIMIT 21

B.3. LËNDËT OSE PROGRAMET ALTERNATIVE NË TË CILAT DO TË ZBATOHET PEI 22

B.4. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PËRPARIMIT TË NXËNËSIT 22

PJESA C: PLANI DIDAKTIK I PERSONALIZUAR (PDP) 24

C.1. KUADRI INFORMUES 25

C.2. FUNKSIONIMI I AFTËSIVE BAZË (SHKRIM, LEXIM DHE LLOGARITJE) 25

C.3. STRATEGJI METODOLOGJIKE DHE DIDAKTIKE 26

C.4. PLAN I VEPRIMIT PËR LËNDËN 27

C.5. BASHKËPUNIMI ME FAMILJEN 28

PJESA D: PROJEKTI PËR JETËN (PPJ) 29

D.1. PLANIFIKIMI I KALIMIT TË NXËNËSIT NGA NJË KONTEKST NË TJETRIN 29

D.2. OBJEKTIVAT SPECIFIKE PËR LEHTËSIMIN E KALIMIT TË NXËNËSIT NGA NJË KONTEKST NË TJETRIN 29

Bibliografi 31

Shtojca: Përcaktimi i vendit ku do të vijojë mësimin 32

SHKURTIME

AK – Aftësi e kufizuar
AF – Arsimi fillor
AL – Arsimi i lartë
AML – Arsimi i mesëm i lartë
AMU – Arsimi i mesëm i ulët
APU – Arsimi parauniversitar
DN – Dispozita Normative
KIANAK – Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm për nxënësit me aftësi të kufizuar
KKBDF – Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KMDAR – Komisioni multidisiplinor i Drejtorisë Arsimore Rajonale
KMZA – Komisioni multidisiplinor i Zyrës Arsimore
KNF-FR – Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksioneve për Fëmijë dhe të Rinj
NVE – Nevoja të veçanta edukative
PD – Pikë e dobët
PDF – Profili dinamik funksional
PDP – Plan didaktik i personalizuar
PEI – Plan edukimi individual
PF – Pikë e fortë
PPJ – Projekti për jetën
RP – Rezultatet e pritshme
VN –V është rësi në të nxënë

HYRJE

Shqipëria sot paraqitet në arenën ndërkombëtare si një vend që, përveçse ka aderuar në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, si dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, ka bërë përpjekje të rëndësishme për përmirësimin ligjor dhe zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse. Megjithë përpjekjet e bëra deri sot, konteksti shqiptar shfaq shumë pengesa dhe sfida për të kapërcyer drejt rritjes së mirëqenies së personave me nevoja të veçanta, të cilët jetojnë në territorin shqiptar (Save the Children, 2013).

Në këtë kuadër, Save the Children nëpërmjet projektit "Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri", synon të identifikojë nevojat që shfaqen në kontekstin edukativ shqiptar si nga ana e institucioneve arsimore, ashtu edhe nga ana e punonjësve arsimorë, të cilët u ofrojnë shërbime edukative fëmijëve që frekuentojnë këto institucione.

Gjatë tre viteve të fundit të zbatimit të projektit të lartpërmendur nga Save the Children dhe partneri i saj zbatues MEDPAK, është vënë re që praktikat pozitive të mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta lënë shumë për të dëshiruar. Një ndër to është edhe mbështetja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore përmes Planeve Edukative Individuale (PEI). Ndër problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të projektit, mund të përmendet mospërgatitja në nivelin e duhur e mësuesve në shërbim, për hartimin dhe zbatimin e planeve PEI për fëmijët me NVE, si dhe larmi modelesh PEI, të cilët nuk përputheshin me standardet evropiane dhe botërore të këtyre modeleve. Si rrjedhojë, këto modele linin hapësira për ngatërresa dhe mosadresim të nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve në mënyrë të përshtatshme.

Udhëzuesi që keni tashmë në dorë është pjesë shoqëruese e standardeve që kërkohen të zbatohen në arsimin parauniversitar të gjithë vendit. Ai është një material ndihmës për mësuesin dhe të gjithë ata të cilët mbështesin procesin edukativ të fëmijës me NVE. Udhëzuesi mban parasysh ndryshimet që duhet të ndodhin në procesin mësimor-edukativ në institucionet arsimore, duke dëshiruar ecurinë më të mirë të fëmijëve dhe mësuesve në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, me qëllim rritjen e cilësisë së veprimit edukativ dhe mësimor.

RËNDËSIA E PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Fëmijët me nevoja të veçanta përballen me pengesa, të cilat nuk i lejojnë të gëzojnë të drejtat e tyre themelore. Ata shpesh përjetojnë pabarazi në formën e mundësisë së mohuar në arsim apo në kujdesin shëndetësor, për shkak të gjendjes së tyre, si dhe cenim të dinjitetit nëpërmjet dhunës, abuzimit, neglizhimit, paragjykimit ose mosrespektimit. Save the Children, si organizatë e pavarur udhëheqëse në botë, ka një mandat të qartë për të siguruar se fëmijët me nevoja të veçanta përfshihen në sistemin arsimor dhe në programe të ndryshme në jetën shoqërore. Ata duhen respektuar si pjesëmarrës aktivë dhe agjentë të ndryshimit dhe jo si përfitues pasivë të ndihmës bamirëse. Për këtë qëllim, Save

the Children në kuadër të projektit të vet "Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri", të financuar nga Koperacioni Italian i Zhvillimit/ Ministria e Jashtme Italiane, me këtë udhëzues, i cili shpjegon hapat e veçantë se si duhet ndërtuar një PEI, synon t'u vijë në ndihmë gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta edukative, si dhe mësuesve e stafit tjetër mbështetës brenda shkollës, për të përfshirë të gjithë fëmijët në sistemin arsimor në Shqipëri.

Ky udhëzues u ndërtua në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë të Universitetit "Fan S Noli" të Korçës dhe Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan.

SFONDI I TË DREJTAVE

Save the Children përpiqet për një botë ku çdo fëmijë përmbush të drejtat për mbijetesë, mbrojtje, zhvillim dhe pjesëmarrje. Kjo organizatë e zhvillon veprimtarinë e saj në respekt të parimeve të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF). (UN General Assembly, 1989). Neni 2 i KKBDF-së u bën thirrje shteteve palë të parandalojnë të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe argumentimin e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, Komiteti që parashikon KKBDF-ja, ka nxjerrë një deklaratë mbështetëse që nënvizon të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfshirë të drejtat për arsimim dhe veprimtari argëtuese. Po ashtu, këto të drejta mbështeten nga Konventa e Kombeve për Personat me Aftësi të Kufizuara, që i detyron të gjitha shtetet palë të marrin të gjitha masat për të siguruar gëzimin e plotë nga fëmijët me aftësi të kufizuara të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, njësoj si fëmijët e tjerë (Neni7) (UN General Assembly, 2007).

TË DREJTAT E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR[1] NË KUADRIN LIGJOR SHQIPTAR

- Referuar **Ligjit nr.69/2012** Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, **neni 65** ***"Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara"*** thotë:

  1) "Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas *planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta*";

  2) "Në institucionet arsimore të zakonshme, *programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënit në institucion dhe psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit dhe nxënësit.* Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës."(Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2012).

- Referuar **Dispozitave Normative** (2013), Për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Kreu XV "Arsimimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara", në nenet e poshtësjellura theksohet:

  Neni 93 "Ngritja e komisionit pranë DAR /ZA-së dhe detyra të tij", nw pikat 2, 5, 6, 9, 10, 11 specifikohen disa prej procedurave dhe detyrave të komisionit në bazë të rolit dhe funksioneve të këtij të fundit.

1. Në këtë dokument termi "**Aftësi e Kufizuar**" po përdoret duke iu referuar terminologjisë së përdorur në legjislacionin aktual shqiptar.

1. Komisioni, me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij.
2. Prindi i paraqet komisionit pranë DAR/ZA-së raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, kur fëmija është vlerësuar nga ky KomisionMjekësor.
3. Komisioni: a) njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin përndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuarose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas; ç)sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin;d) rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese; dh) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka.
4. Komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me aftësi të kufizuara (AK).
5. Komisioni njofton me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale.
6. Komisioni pranë DAR/ZA-sëudhëzon komisionet e institucioneve arsimore për punën me nxënësit me AK.

Neni 94 "Detyrat e DAR/ZA-ve", në pikën 5 shprehet: "DAR/ZA-ja ka këto detyra: Organizon, nëpërmjet njësisë së shërbimit psiko-social pranë DAR/ZA-së, bashkëpunimin e mësuesve të shkollave të specializuara me mësuesit e shkollave të zakonshme, për hartimin dhe vënien në jetë të planeve edukative individuale (PEI) të nxënësve me AK.

Neni 95" Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm", në pikën 2 shprehet: "Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm, bazuar në vlerësimin e komisionit pranë DAR/ZA-së:

a) udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-t dhe i miraton;
b) ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-t;
c) ndjek ecurinë e fëmijëve me AK;

Neni 96 "Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm", në pikën 1 shprehet: "Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm është përgjegjës për:

a) realizimin e integrimit të nxënësve me AK në veprimtaritë e institucionit arsimor;
b) funksionimin e komisionit të institucionit;
c) realizimin cilësor të PEI-t.;

Neni 97 "Mësuesi ndihmës dhe mësuesi lëndor në institucionet arsimore të zakonshme",- bashkëpunimi me prindërit, në pikat 2, 3 dhe 4 shprehet:

2. Mësuesi ndihmës, në bashkëpunim me mësuesin lëndor dhe prindin, hartojnë dhe venë në jetë PEI-n e fëmijës. PEI bazohet në dokumentet zyrtare të kurrikulës dhe përmban edhe objektiva për aftësitë e vetëndihmës dhe aftësi të tjera sociale, që nxënësi duhet të arrijë, sipas udhëzimeve të komisionit pranë DAR/ZA-së.
3. Mësuesi ndihmës shënon në planin ditar aspekte të ecurisë së fëmijës me AK.
4. Ndryshimi i PEI-t vendoset nga komisioni i institucionit në bashkëpunim me prindërit e fëmijës, pas propozimit të mësuesve ose prindërve;

Neni 98 - Ndjekja e shkollës;Vlerësimi i nxënësve me AK; Dokumente të përfundimit të shkollimit, në pikat 3, 4 dhe 6 shprehet:

3. Transferimi i nxënësit me AK nga një institucion arsimor i zakonshëm në një tjetër, bëhet sipas procedurave të transferimit të nxënësve të përshkruara në DN. Në shkollën pritëse dorëzohet një raport i hartuar nga komisioni i institucionit arsimor i firmosur nga drejtori i shkollës ku paraqitet PEI dhe ecuria e nxënësit në realizimin e tij.
4. Vlerësimi i nxënësve me AK është si ai i nxënësve të tjerë. Nxënësi me AK, i cili ndiqet me PEI, vlerësohet në përputhje me objektivat e vendosura në PEI-n përkatës.[…]
6. Nxënësi me AK, pas përfundimit të çdo klase, pajiset me dëftesë që përmban një rubrikë, ku përshkruhen përmbledhtas objektivat kryesore të PEI-t të tij.

Neni 99 – Nxënësit që nuk dëgjojnë ose/dhe nuk flasin ose/dhe nuk shohin, në pikën 1 dhe 2 thuhet:

1. Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail. Materialet ndihmëse mësimore janë në formatin e përshtatshëm. (në Brail, tekste me shkronja të mëdha etj). Kur është e nevojshme, përdoren versione të thjeshtuara të tekstit të lëndës mësimore.
2. Kurrikula e nxënësve që nuk shikojnë apo nuk flasin ose/dhe dëgjojnë është përgjithësisht kurrikula e zakonshme.
   Më rekomandimin e komisionit pranë DAR/ZA,nxënësve u sigurohen edhe tekste për mësimin e gjuhës së folur dhe komunikimin global.

Neni 100 - Shkollat e specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuara, në pikën 3 shprehet: **"**Nxënësit, që sipas gjykimit të komisionit të vlerësimit, kanë nevojë për trajtim të individualizuar, punojnë me PEI."

SI TA PËRDORIM KËTË UDHËZUES

Ky dokument ka për qëllim t'u vijë në ndihmë mësuesve dhe operatorëve të tjerë që punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta edukative në kontekstin shkollor. Materiali paraqitet si një paketë e strukturuar mjetesh udhëzuese, për planifikimin e ndërhyrjeve edukative dhe përshtatjet e nevojshme të aspektit didaktik dhe të kurrikulës për këtë kategori nxënësish.

Prej më shumë se dy dekadash në Shqipëri, organizma qeveritare dhe joqeveritare kanë hartuar apo përshtatur modele dhe dokumente të ngjashme për t'u ardhur në ndihmë mësuesve për hartimin e planit edukativ individual, për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Hartimi i këtij udhëzuesi praktik bazohet në udhëzimet dhe detyrimet e përcaktuara në ligjislacionin shqiptar (Ligji nr. 69/2012; Dispozitat Normative, 2013; Ligji nr. 93/2014) për garantimin e së drejtës për arsimim cilësor të çdo individi[2], pa u diskriminuar nga aftësia e kufizuar e tij.[3] Ky udhëzues vjen pas një pune të gjatë konsultimesh me mësues dhe specialistë të fushës së edukimit, mbi nevojat e mësuesve që shërbejnë sot në institucionet arsimore të nivelit parauniversitar, për të patur një mjet pune praktik dhe të standardizuar, i cili pasqyron në mënyrë të qartë hapat që duhet të ndiqen për përfshirjen sa më të mirë të nxënësve me NVE në institucionet arsimore.

Materiali që sillet në këtë udhëzues vjen në formatin e një pakete, të strukturuar në katër fashikuj, të cilët lidhen ngushtë dhe janë në funksion të njëri-tjetrit, duke plotësuar atë që po e quajmë "Udhëzues Praktik".

Udhëzuesi është strukturuar në katër pjesë për t'ju përgjitur tre synimeve:



2. Neni 5 - **E drejta për arsimim .** 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, *aftësia e kufizuar* ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.(Ligji n.69, 2012)

3. "**Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara**" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.(Ligji n.93, 2014).

Udhëzuesi ka për qëllim t'i vijë në ndihmë mësuesit, i cili, duke iu referuar përvojës së tij profesionale në fushën e edukimit, organizon idetë, planifikon strategjitë dhe metodat e mësimdhënies dhe merr vendime mbi përshtatjet e duhura që duhet të realizohen në aspektin e kurrikulës, mjediseve etj., për t'i ofruar nxënësit një arsimim cilësor.

Udhëzuesi fillon me pjesën se çfarë është një Plan Edukativ Individual (PEI), kur hartohet një PEI për një nxënës, përfitimet kryesore që mund të ketë një nxënës kur me atë punohet sipas një plani PEI referuar nevojave të tij. Dokumenti shpjegon rëndësinë e gërshetimit të PEI-t me plan programin e përgjithshëm dhe hapat që duhen ndjekur për hartimin e PEI-t.

Në vijim të këtij informacioni:

Pjesa A"*Profili dinamik funsional i nxënësit*" përmbledh informacionin bazë që duhet të kemi për nxënësin në hartimin e një plani PEI.

Pjesa B"*Plani Edukativ Individual*" analizon arritjet në kompetencat e nxënësit për secilën fushë zhvillimore.

Pjesa C,"*Plani Didaktik i Personalizuar*", vazhdon me udhëzime konkrete se si vështirësitë dhe nevojat specifike të nxënësit mund të zbërthehen në strategji dhe metodologji të caktuara që duhet të ndjekë mësuesi i klasës ose lëndës, me qëllim që nxënësit me nevoja te veçanta arsimore të kenë sa më shumë përfitime.

Pjesa D,"Projekti për Jetën", është pjesa e fundit e udhëzuesit dhe parashikon masat përgatitore që duhen ndërmarrë në rastin e transferimit të nxënësit nga institucioni përcjellës dhe ai pritës.

SHPJEGIM KONCEPTESH

Çfarë kuptojmë më nevoja të veçanta

Nevoja të veçanta janë nevojat që shkaktohen si pasojë e kombinimit të kushteve të jetesës dhe cilësive të individit. Një mjedis i paaksesueshëm dhe pamundësia e lëvizjes më këmbë, rezultojnë në një kufizim mundësish për personin, që të mund të lëvizë lirshëm në mjedis. Ky kufizim bëhet shkak për një nevojë të veçantë, që minimalisht kërkon ndërhyrje të dyfishtë: e para, përshtatshmëri mjedisore dhe, e dyta, rehabilitim të aftësisë së ecjes të personit.

Veçantësia e një nevoje varet nga kërkesat dhe interesi për përdorimin e mjedisit dhe sendeve. P.sh. në arsim, nevojat e veçanta lidhen kryesisht me të nxënët dhe kërkohet ndërhyrje në kurrikul, me qëllim që ajo të bëhet e përshtatshme për mësim. Por, nga ana tjetër, vetëm ndërhyrja në kurrikul nuk garanton përgjigjen ndaj nevojës së veçantë në të nxënë, prandaj duhen bërë edhe ndërhyrje të tjera, si përgatitja profesionale e stafit pedagogjik për të punuar me nxënës me nevoja të veçanta në të nxënë, përshtatshmëria e shkollës dhe e mjeteve shkollore që të jenë lehtësisht të përdorshme prej nxënësve me aftësi të kufizuara, nxitja e inteligjencës së shumëfishtë njohëse, përveç koncepteve logjike, etj.(Xhamo, Ndrio, Poni, Koka, Goci, & Çela, 2010).

Cili quhet nxënës me nevoja të veçanta edukative

Nxënësit me NVE janë ata që kanë nevoja më specifike sesa nxënësit e tjerë në kryerjen e funksioneve të jetës së përditshme dhe në të mësuar, të cilëve u nevojitet mbështetje për t'i kryer sa më mirë ato. Si rregull, të gjithë nxënësit kanë nevoja të ndryshme në të mësuar, në varësi të stileve të të mësuarit dhe të inteligjencës së shumëfishtë, por nxënësit me NVE i kanë edhe më të veçanta këto nevoja, sepse

përveç stileve të ndryshme të të mësuarit, nevojat e tyre mund ta kenë origjinën edhe në shkaqe që lidhen me dëmtimet fizike dhe njohëse, që ndikojnë në aftësitë në të mësuar.

Nxënësit me nevoja të veçanta, janë si ata që kanë vështirësi në të mësuar, ashtu edhe ata që janë të talentuar.

Nxënësit e talentuar janë me nevoja të veçanta, pasi talenti i tyre kërkon vëmendje të veçantë që të zhvillohet, në përputhje me mundësitë e tyre, duke qenë se janë më të përparuar në drejtim të talentit, krahasuar me nxënësit e tjerë të klasës.

Nxënësit e tjerë me nevoja të veçanta janë fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët mund të kenë dëmtime fizike ose intelektuale, çrregullime emocionale ose të sjelljes. (po aty).

KUJDES

Termi NVE është një përkufizim pedagogjik dhe jo klinik: nuk është një etiketë diagnozë, pra nuk ekziston diagnoza NVE

Ky udhëzues përdor termin ***nevoja të veçanta edukative (NVE)***, për t'iu referuar çdo fëmije që mund të kërkojë mbështetje shtesë për t'u përfshirë dhe për të shfaqur plotësisht aftësitë e tij në klasë ose në veprimtari të tjera shkollore, qoftë fëmijë me aftësi të kufizuar, çrregullim në të nxënë apo çregullime specifike të zhvillimit.

NEVOJA TË VEÇANTA EDUKATIVE (NVE)

Nxënës me aftësi të kufizuar

Janë ata nxënës që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat mjedisore dhe ato qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. (Ligji Nr. 93, 2014)

Nxënës me çrregullime specifike neurozhvillimore (Shiko DSM5)

Janë ata nxënës të cilët janë diagnostikuar në një ose më shumë nga çrregullimet e mëposhtme:

Çrregullime specifike të të nxënit

Çrregullime të vëmendjes dhe hiperaktiviteti

Çrregullime specifike të gjuhës

Çrregullime në koordinimin motorik dhe dispraksi

Çrregullime në aftësitë joverbale

Çrregullime të spektrit autik të nivelit të lehtë

Funksioni intelektual në limit

Nxënës me nevoja të tjera edukative

Janë ata nxënës të cilët hasin vështirësi në të nxënë dhe në pjesëmarrje shoqërore dhe ndaj të cilëve kërkohen ndërhyrje didaktike të individualizuara apo të personalizuara, sepse ndërhyrjet e zakonshme nuk janë të mjaftueshme për të siguruar shërbime educative efikase.

Përfshihen nxënësit që janë në proces diagnostikimi të një çrregullimi të sjelljes, nxënës me disavantazhe social-ekonomike, gjuhësore apo kulturore .

Figura 1. Nxënës me nevoja të veçanta edukative

Grupi më i madh i fëmijëve që kërkojnë një mbështejte shtesë, është grupi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe si rrjedhim, udhëzuesi ka si synim parësor këta fëmijë. Megjithatë, duhet patur parasysh që në shumë kontekste, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të të gjitha llojeve të lartpërmendura, nuk janë diagnostikuar kurrë nga një mjek specialist apo nga një komision i thirrur për këtë punë. Për më tepër, edhe fëmijët të cilët nuk flasin gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi (grupet minoritare) ose të cilët për arsye të ndryshme shoqërore ekonomike e familjare nuk marrin kujdesin e duhur në shtëpi, mund të kërkojnë mbështetje shtesë, pavarësisht se në aspektin teknik ata nuk kanë ndonjë aftësi të kufizuar. Për këtë arsye, gjatë këtij udhëzuesi do të përdorim termin "*nevoja të veçanta edukative*" në mënyrë që vetë udhëzuesi të mos i përjashtojë fëmijët që kërkojnë mbështetje shtesë dhe që nuk kanë një identifikim apo raport specifik për aftësi të kufizuar.

Cili quhet nxënës me çrregullime specifike të të nxënit

Nxënësi, i cili shfaq vështirësi të konsiderueshme në përvetësimin dhe përdorimin e aftësive shkollore, siç janë aftësitë në të lexuar, në të shkruar, në llogaritje, në të shprehurit me shkrim, në të kuptuarit e tekstit të shkruar, të cilat nuk mund të lidhen me faktorëve të tjerë si aftësi e kufizuar e nivelit të rëndë apo e përcaktuar në bazë të arritjes së kritereve të pritshme të të nxënit, krahasuar më mundësitë e subjektit (Cornoldi, 2007).

Është e nevojshme të dallojmë çrregullimet specifike të të nxënit nga vështirësitë e të nxënit. Vështirësitë, në ndryshim nga të parat, nuk janë të lindura, nuk shfaqin rezistencë ndaj ndërhyrjeve të studiuara, por kanë përmirësim dhe pësojnë efektin e automatizimit edhe pse në kohëzgjatje të shtrirë.(AA.VV, 2013)

KUJDES

Këto lloj çrregullimesh nuk duhen ngatërruar me ulje- ngritjet e rezultateve shkollore të nxënësve, me vështirësitë shkollore të shkaktuara nga mungesa e mundësive, mësimdhënies jo cilësore, faktorëve kulturorë, vështirësive në fushën njohëse dhe atë emocionale apo të një lloji tjetër, të cilat pengojnë përparimin shkollor të fëmijës. (Cornoldi, 2007).

Çfarë nënkuptohet me mjete ndihmëse

Pajisje ose një sistem produktesh, që mund të ndryshohen, të përshtaten dhe të përdoren për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara për kapërcimin e pengesave dhe për të përmirësuar mundësitë e tyre për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë.(Ligji nr.93, 2014)

Çfarë nënkuptohet me masa përjashtuese

Ndërhyrje të cilat i lejojnë nxënësit të mos kryejë disa detyra apo veprimtari, të cilat, për shkak të vështirësisë që nxënësi shfaq, rezultojnë shumë të vështira dhe nuk ndihmojnë të nxënët. (Stella, Cornoldi, Lucangeli, & Fedeli, 2016)

ÇFARË ËSHTË NJË PLAN EDUKIMI INDIVIDUAL (PEI)

Plani Edukativ Individual është:

- një dokument i shkruar, i cili përshkruan programet edukative të veçanta dhe /apo shërbime që i nevojiten një nxënësi, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të nevojave dhe aftësive që ai ka; nevoja dhe aftësi të cilat ndikojnë në mundësitë e tij për të nxënë dhe për shprehur atë që ka nxënë;
- dokumentim i ndërhyrjeve të programuara, për të ndihmuar nxënësin të rritë pritshmëritë në të nxënë dhe të identifikojë pikat e forta dhe nevojat që ai ka në procesin e të nxënit;
- një dokument pune ku identifikohen përshtatjet e nevojshme të rezultateve të të nxënit në dallim nga ato rezultate që parashikohen dhe hartohen për nivelin arsimor tipik, bazuar në standartet e arritjeve të kompetencave sipas shkallëve (IZHA; MAS, 2016).
- një instrument, për nxënësit, për prindërit e nxënësve dhe për të gjithë ata të cilët kanë përgjegjësi për edukimin formal, informal dhe joformal të nxënësve.(Ministry of Education, Ontario CA, 2004)

PLAN

Objektiva për të arritur, të formalizuar në terma zbatues dhe specifikë;
Koha që parashikohet të arrihen rezultatet e projektuara;
Hapat që parashikohen të ndiqen;
Strategjitë dhe **materialet** që do të përdoren për të konkretizuar hapat e planifikuara;
Kriteret që do të merren parasysh për verifikimin e vlefshmërisë së ndërhyrjeve të zhvilluara

EDUKATIV

Plani është **"edukativ"** sepse projektohet të prekë të gjitha fushat, aktorët, kontekstet ku fëmija fiton njohuritë, shprehitë, shkathtësitë, aftësitë domethënëse, vlerat morale dhe kulturore, të përcaktuara nga shoqëria.

INDIVIDUAL

Plani është **individual** kur vendos objektiva të përbashkëta njohëse për të gjithë klasën, duke përshtatur metodologjitë dhe strategjitë e ndërhyrjeve në funksion të karakteristikave individuale të çdo nxënësi.

KUR HARTOHET DHE PSE ËSHTË E RËNDËSISHME NDJEKJA E FËMIJËS ME PLAN EDUKIMI INDIVIDUAL

PEI hartohet për të gjithë fëmijët për të cilët është marrë vendimi për ndjekjen me këtë plan nga komisionet përkatëse.

Një PEI hartohet pasi është kryer vlerësimi i fëmijës, nga KMDAR dhe KIANAK, ashtu siç parashikohet në Dispozitat Normative në fuqi dhe udhëzimet e nxjerra për këtë aspekt.

Vendimi për ndjekjen e një fëmije me plan **PEI**, merret për një periudhë kohe të caktuar, pas së cilës, ekipi vlerësues, rivlerëson nevojat e fëmijës për mbështetje dhe më pas merr vendim nëse duhet të vazhdohet apo të ndërpritet ndjekja me plan PEI.

Në rastet kur shihet se fëmija ka ndryshime të dukshme apo në të kundërtën, nuk ecën përpara aq sa pritet, mund të bëhet rivlerësimi edhe më herët se ç'parashikohet nga komisioni.

SI GËRSHETOHET PLANI EDUKATIV INDIVIDUAL ME KURRIKULËN SHKOLLORE?

Natyra dhe shkalla e PEI-t ndryshon në lidhje me nevojat e fëmijëve.

Gjatë hartimit të një PEI, krahas objektivave që lidhen drejtpërdrejt me procesin mësimor, vendosen dhe objektiva për të realizuar shoqërizimin e fëmijës brenda jetës shkollore.

Në rastet kur parashikohet se fëmija nuk mund të arrijë rezultatet e disa lëndëve mësimore apo fushave të veprimtarive, ajo lëndë mund të ndiqet me *plan të individualizuar*, kështu që caktohen objektiva individuale për fëmijën për atë lëndë apo fushë.

Në këtë rast, edhe vlerësimi bëhet në mënyrë individuale, në bazë të objektivave të caktuara. Vendimi për individualizim duhet të vijë nga ekipi vlerësues pas vlerësimit të fëmijës.

E veçanta e PEI-t qëndron në atë që ai përgatitet nga një grup ekspertësh, mësuesit si dhe me pjesëmarrjen e plotë të prindit.

Një plan individual nuk është përsëritje e planeve të tjera, por duhet të jetë pjesë plotësuese e planifikimit shkollor.

Mësuesi në shkollë punon duke iu referuar parimeve bazë të kornizës kurrikulare (MAS, 2014), për t'iu ofruar nxënësve një arsimim cilësor.

Është e natyrshme që plani PEI të integrohet brenda kurrikulës shkollore dhe nga ana tjetër kurrikula të krijojë hapësira për të hartuar planin PEI.

Ndërsa kurrikula kërkon që te nxënësi të arrihen disa kompetenca kyçe dhe specifike në formën e aftësive, shprehive shkathtësive, plani PEI kërkon që te nxënësi të arrihen disa objektiva në përshtatje me aftësitë, mundësitë dhe interesat e nxënësit, mbështetur në fushat e zhvillimit të tij. Nëse kurrikula si parim të saj ka gjithëpërfshirjen dhe duhet të njohë, të pranojë, të respektojë dhe t'u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve, hartimi dhe zbatimi i planit PEI, është një instrument që synon gjithëpërfshirjen e nxënësit brenda mjedisit ku ai mëson. Nëse kurrikula siguron njëherësh baraspeshën ndërmjet njohurive e aftësive të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre, kjo është ajo çka mund të shfrytëzohet te plani PEI lidhur me interesat dhe aftësitë e nxënësit. Nëse kurrikula krijon hapësirë për fleksibilitet dhe autonomi, kjo bën që mësuesi të jetë i lirë të sigurojë, hapa, mjete, strategji e metoda mbi bazën e të cilave do të ndjekë ecurinë e planit PEI.

Grafikisht, kjo lidhje mes kurrikulës së zakonshme shkollore dhe planit PEI jepet në figurën e mëposhtme.



Skema 1. Gërshetimi i elementeve të kurrikulës së zakonshme me elemete të PEI-t

CILAT JANË HAPAT KRYESORE NË NDËRTIMIN E PEI-t[4]

Hapi 1-Referimi/raportimi[5] në Komisionin eVlerësimit pranë DAR/ZA-së (ose institucionit arsimor të zakonshëm)

Prindi, **drejtori i shkollës** ose **persona të tjerë të autorizuar në DN**, dërgojnë pranë DAR/ZA-së një kërkesë për vlerësim të nevojave të nxënësit. Kjo kërkesë tregon se personat e mësipërm besojnë se nxënësi mund të ketë AK, që mund të ndikojë në arritjet mësimore. Pëlqimi i prindërve duhet të merret para se të bëhet vlerësimi i tij. Vlerësimi duhet të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme, pas marrjes së pëlqimit të prindërve.

Nëse besohet se fëmija/nxënësi ka një vështirësi në të nxënë, vendimin për vlerësimin e tij mund ta bëjë **Komisioni në bazë institucioni arsimor** (kopshti/shkolle)

Hapi 2-Vlerësimi i nxënësit nga Komisioni iVlerësimit pranë DAR/ZA-së (ose institucionit arsimor të zakonshëm)

Komisioni multidisiplinar kryen identifikimin e nevojave funksionale arsimore dhe ndërton profilin dinamik funksional të nxënësit, bazuar në raportin e paraqitur nga Komisioni për Vlerësimin e

4. Përcaktimet fëmijë dhe /apo nxënës janë përdorur në kontekstet përkatëse: nëse PEI hartohet në institucionin parashkollor mbahet parasysh fëmija, nëse PEI hartohet ë shkollë, mbahet parasysh nxënësi.

5. Referimi është proces i ndryshëm nga raportimi. **Raporti** përbën një dokument formal të shkruar, i cili ndërtohet nga aktorë që kanë detyrim ligjor të komunikojnë raste, që shfaqin elemente specifike devijuese të përshkruara në raport, pa u shoqëruar nga komente personale subjektive, me organe të tjera administrative apo me profesionistë që veprojnë në institucione publike.
Referimi i rastit është ai proces nëpërmjet të cilit, profesionistë të ndryshëm, apo çdo subjekt tjetër, të cilët nuk janë të detyruar me ligj t'i përmbahen një procedure standarde për komunikimin me subjekte të ndryshme për raste që shfaqin elemente specifike devijuese, komunikojnë më qëllim informimin me shkrim apo me gojë, një organi apo subjekti i cili ka detyrim ligjor të raportojë rastin e referuar.

Aftësisë së Kufizuar dhe nevojave për ndihmë dhe mbështetje për nxënësin në fjalë. KMDAR-i përgatit një raport të detajuar me shkrim mbi arritjet dhe nevojat e nxënësit, duke i dhënë sugjerimet e veçanta për nxënësin që ka vlerësuar, sugjerime këto të cilat duhet të merren parasysh nga KIANAK-u në mbështetje të fëmijës me planin PEI.

Hapi 3-Fitimi i së drejtës për marrjen e shërbimeve

Nëse shihet që nxënësi paraqet nevoja të veçanta, ai/ajo ka të drejtë të marrë shërbimin arsimor, bazuar në nevojat e tij, nëpërmjet hartimit të ndërhyrjeve edukative-individuale të parashikuara sipas dispozitave normative.

Hapi 4-Hartimi i PEI-t

Komisioni i shkollës i ngritur me qëllim hartimin e PEI-t, në bazë të vlerësimit dhe udhëzimit të dhënë nga DAR/ZA-ja, harton PEI-n. Prindërit dhe nxënësi (kur është e përshtatshme) janë pjesë e ekipit. Takimi për ta shkruar PEI-n duhet të mbahet brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni vlerësues, pas marrjes së vendimit nga ky i fundit.

Hapi 5-Zbatimi i PEI-t

Të gjithë personat përgjegjës për zbatimin e PEI-t, duke përfshirë edhe prindërit, pajisen me një kopje të tij në mënyrë që të njohin përgjegjësitë e veta në plan. Pjesëtarë të komisionit takohen periodikisht për të parë ecurinë e zbatimit të PEI-t, bazuar në vendimet e komisionit vlerësues.

Hapi 6-Rishikimi i PEI-t

Komisioni i shkollës vlerëson se sa janë arritur objektivat e PEI-t në fund të çdo periudhe **3 mujore** të parashikuar në planin PEI. Në bazë të arritjeve, ai bën rishikimin dhe përshtatjen e këtyre objektivave. Ekipi i PEI-t mund të bëjë rishikim të objektivave të planit, kur e sheh të nevojshme, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të ndërhyrjeve edukative drejtuar nxënësit/ fëmijës.

Hapi 7-Rivlerësimi i nxënësit/fëmijës

Komisioni i vlerësimit duhet të rivlerësojë nxënësin/fëmijën në përfundim të çdo cikli shkollor. Rivlerësime mund të kryhen edhe më herët me kërkesë të prindit dhe komisionit të institucionit arsimor.

Arritjet që ka patur nxënësi ose fëmija gjatë kësaj periudhe komunikohen me prindërit.

KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR HARTIMIN E PEI-T?

Plotësimi i Planit të Edukimit Individual është përgjegjësi e grupit të punës, që merret me hartimin e planit të ndërhyrjes në të gjitha fushat e parashikuara në PEI, pra anëtarëve të KIANAK-ut, siç mund të jenë: mësuesi/it e lëndës, mësuesi ndihmës (nëse ka), punonjësit e shërbimit psiko-social në institucionin arsimor, prindi/kujdestari ligjor i fëmijës, si dhe çdo individ tjetër që mund të sjellë informacion të nevojshëm/plotësues për ndjekjen e planit PEI.

Në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Vlerësimit pranë institucionit dhe prindërit, duhet të sigurohet që një kopje të tij ta ketë prindi/ kujdestari ligjor i fëmijës dhe një kopje të jetë pjesë e dosjes së nxënësit.

PJESA A

TË DHËNA PËR NXËNËSIN DHE PROFILI DINAMIK FUNKSIONAL I TIJ

Kjo pjesë ka për qëllim të mbledhë të dhënat kryesore të fëmijës, për të cilat paraprakisht është rënë dakord me prindin ose kujdestarin e tij.
Pjesa administrative dhe e profilit dinamik funksional, përbëhet prej disa pikave, të cilat synojnë të regjistrojnë informacionin kryesor të fëmijës/nxënësit për të cilin krijohet PEI. Pikat e pjesës administrative të PEI-t janë të radhitura si më poshtë:

A.1. TË DHËNA DEMOGRAFIKE TË NXËNËSIT

Në këtë pjesë kërkohet të shkruhet informacioni i saktë për emrin e nxënësit, mbiemrin e tij, gjinia, ditëlindja, emri i shkollës ose institucionit parashkollor, klasa apo grupmosha së cilës i përket, viti shkollor, emri dhe mbiemri i prindit ose kujdestarit, adresa e banimit, kontaktet e prindit apo kujdestarit të nxënësit, numri i telefonit (fiks ose mobil), përbërja familjare.
Gjithashtu duhet shënuar emri i mësuesit kujdestar, mësuesit ndihmës (nëse ka) si dhe personave të tjerë mbështetës (p.sh. psikologu, fizioterapisti, logopedisti, etj.)
Kur flitet për persona të tjerë mbështetës, mbahen parasysh persona, të cilët mund të ofrojnë shërbime plus për nxënësin krahas mësuesit kujdestar dhe mësuesit ndihmës. Nëse ka persona të tillë, përcaktohet edhe pozicioni i tyre në ndihmë të tij (fizioterapist, logopedist, sanitar, punonjës teknik etj.)

A.2. ARSYEJA PËR HARTIMIN E PEI-T

Tek arsyet për hartimin e PEI-t shënohet nëse fëmija/nxënësi ka:

AK (aftësi të kufizuar);
VN (vështirësi në të nxënë)
Vështirësi të tjera

Për **AK** shënohet dhe diagnoza, për **VN** shënohet lloji i vështirësisë në të nxënë, specifikuar nga specialisti që ka bërë vlerësimin, ndërsa në lidhje me vështirësitë e tjera specifikohet vështirësia e identifikuar, si dhe data e identifikimit.
Gjithashtu përcaktohet se cili komision e ka bërë vlerësimin, duke shënuar shenjën **X**, dhe rekomandimet qw ka nxjerrw nw pwrfundim tw vlerwsimit tw kryer (Komisioni: a) njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin përndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuarose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas; ç)sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin;d) rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese; dh) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka. (MASH, 2013))

A.3. HISTORIKU DHE ASISTENCA SHËNDETËSORE

A.3.1. INFORMACION MBI VLERËSIMIN E TË DHËNAVE DHE PËRVOJËN E VITEVE TË FUNDIT

PËRMBLEDHJE E HISTORIKUT TË NXËNËSIT

Në këtë pjesë pasqyrohet përvoja e viteve të fundit, duke përfshirë edhe historikun për shkollimin paraprak të nxënësit. Ky informacion merret gjatë bashkëbisedimit me prindin ose kujdestarin e fëmijës dhe është e preferueshme që përveç emrit të shkollës apo institucionit parashkollor ku ka qenë më parë fëmija/nxënësi,vendndodhja, tipi i shkollës (speciale, e rregullt) niveli dhe lloji i klasës (e bashkangjitur, e rregullt) dhe nëse ai ka ndjekur ndonjë program tjetër edukativ-arsimor, aftësues/ riaftësues jashtë shkollës.

Nga ky bashkëbisedim me prindin/kujdestarin e fëmijës, përcaktohen pika të rëndësishme që lidhen me sjelljen, preferencat e tij, stimujt, mënyrat e komunikimit, autonominë personale, me higjienën etj.

- Çfarë i pëlqen të bëjë (pëlqimet në lojë, veprimtari, ushqime, etj.)
- Si sillet kur është në humor të mirë (shenjat e dallueshme në sjellje, gjuhën e trupit, etj.)
- Stimuj qetësues (çfarë e qetëson, lodrat, ushqimet e preferuara, etj.)
- Komunikimin e kryen nëpërmjet (të folurit, të shkruarit, me gjeste, me tablet, tjetër specifiko)

A.3.2. LLOJET E SHËRBIMEVE TERAPEUTIKE QË NXËNËSI KA MARRË

Të sillen të dhëna për ndërhyrjet e ndryshme që i janë bërë nxënësit (p.sh. d*ëgjimi, shikimi, komunikimi, psikologjike, të sjelljes, fizike, neurologjike, fizioterapi, ndërhyrje të tjera mjekësore, etj.*), duke evidentuar specialistin që ka bërë ndërhyrjen, datën dhe një përshkrim i shkurtër i rezultatit të kësaj ndërhyrjeje. Këto informacione sigurohen nga prindërit/ kujdestarët ligjorë të fëmijës.

A.3.3. GJENDJA AKTUALE SHËNDETËSORE E NXËNËSIT

Këtu shkruhen të gjitha informacionet për gjendjen shëndetësore paraprake dhe të çastit, të fëmijës/ nxënësit, duke plotësuar rubrikat e mëposhtme, si dhe personin përgjegjës për ndjekjen e situatës shëndetësore të fëmijës/nxënësit, gjatë kohës kur ai është në shkollë/kopësht.

Kjo pjesë plotësohet nga **punonjësi i shërbimit social** në institucion, i cili merr informacionin e domosdoshëm nga familjarët apo specialistët që ofrojnë shërbimet, si më poshtë:

- ***Sëmundje dhe vështirësi për t'u pasur në vemendje***
  Këtu paraqiten rekomandimet dhe, nëse këto rekomandime janë bërë nga personeli shëndetësor në formë të shkruar si p.sh: *sëmundje dhe vështirësi për t'u pasur në vëmendje gjatë procesit kur fëmija /nxënësi ndjek mësimin,* si dhe shenjat apo simtomat me të cilat ato shfaqen. Në këto raste të jepen udhëzime si duhet vepruar.
- ***Terapitë/shërbimet mjekësore të rekomanduara.*** Nëse fëmija është duke marrë terapi mjekësore të përshkruar nga personeli mjekësor, kjo terapi duhet shënuar.
- ***Terapia farmakologjike (barnat) gjatë periudhës që frekuenton shkollën.*** Orarin kur do të merren barnat, personi përgjegjës për këtë dhe kontakti i tij.
- ***Ndërhyrjet që fëmija/nxënësi merr brenda institucionit ku mëson.*** Këtu shënohet tipi i ndërhyrjes, sa shpesh duhet të ndërhyet, sa zgjat ndërhyrja, cili është personi/personat që do ta ofrojnë këtë shërbim dhe kontakti i tyre, si dhe çfarë informacioni i domosdoshëm i marrë prej tij/tyre shënohet në këtë rubrikë.

- ***Rehabilitimet që fëmija/nxënësi merr jashtë institucionit ku mëson.*** Plotësohet nëse fëmija/nxënësi ka përfituar prej shërbimeve rehabilituese jashtë institucionit ku mëson dhe cilat janë ato, p.sh: psiko-sociale, motorike, zhvillimit të të folurit apo vazhdon të ndjekë ndonjë seancë apo program me qëllim rehabilitimi, sa shpesh duhet të ndërhyet, sa zgjat ndërhyrja, cili është personi/personat që do ta ofrojnë këtë shërbim dhe kontakti i tyre, si dhe çfarë informacioni i domosdoshëm i marrë prej tij/tyre shënohet në këtë rubrikë.
- ***Pajisjet mbështetëse:*** Këtu shkruhen pajisjet e veçanta mjekësore që fëmija i përdor, tipat e këtyre shërbimeve, p.sh: mjete ndihmëse të dëgjimit, pajisje ndihmëse në lëvizje etj., si dhe sa shpesh e sa gjatë duhet të përdoret pajisja/mjeti, cili është personi/personat që do të ofrojnë këto mjete mbështetëse /ndihmëse, informacioni i përdorimit, kontaktet e personave.
- ***Shërbimet e tjera:*** Nëse fëmija rregullisht apo kohë pas kohe përfiton shërbime që kanë të bëjnë me zhvillimin e përgjithshëm të tij, tipat e këtyre shërbimeve, sa shpesh duhet të ndërhyet, sa zgjat ndërhyrja, cili është personi/personat që do ta ofrojnë këtë shërbim dhe kontakti i tyre, si dhe çfarë informacioni i domosdoshëm i marrë prej tij/tyre shënohet në këtë rubrikë.

A.4. PROFILI DINAMIK FUNKSIONAL (PDF)

Profili Dinamik Funksional është një dokument i cili ndjek Diagnozën Funksionale ku përmblidhen të dhëna përshkruese të nxënësit, të mbledhura nga vëzhgime të kryera këtij të fundit në kontekste të ndryshme, nga individë të ndryshëm që ndërveprojnë me atë: komisioni, familja, shkolla dhe specialistë. PDF-ja ka për qëllim të integrojë informacionet e ndryshme të marra dhe të tregojë, pas futjes në kontekstin shkollor, nivelin e parashikueshëm të zhvillimit që nxënësi mund të arrijë në një hark kohor të shkurtër (gjashtë muaj) dhe të mesëm (dy vjet).
Ky dokument tregon karakteristikat fizike, psikike, sociale dhe afektive të nxënësit dhe vë në dukje si vështirësitë në të nxënë, të cilat mund të kenë shkaqe të ndryshme, me mundësi relative për përmirësim, ashtu edhe aftësitë që nxënësi ka dhe duhen ruajtur, nxitur, përforcuar dhe zhvilluar duke respektuar zgjedhjet kulturore të personit.

- ***Çfarë përmban:*** përshkrimin funksional të nxënësit duke konsideruar aftësitë dhe vështirësitë në aspekte të ndryshme të vlerësuara edhe në bazë të KNF-së (Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksioneve): funksionet dhe strukturat e trupit; veprimtari dhe pjesëmarrje; faktorë mjedisorë.
- ***Përse shërben:*** ndihmon në formulimin, hartimin dhe në përcaktimin e objektivave në Planin Edukativ Individual; ndihmon në përcaktimin e metodologjive të arsyetuara për të zhvilluar aftësitë e nxënësit; ndihmon në evidentimin e pikave të mundshme ku nxënësi shfaqet më i gatshëm për të bashkëpunuar; ndihmon në programimin e ndërhyrjeve, duke iu mëshuar aftësive të nxënësit dhe pikave të forta të dalluara në PDF, si. dhe "kanaleve" alternative për të ndërtuar punën me nxënësin me qëllim për të arritur sukses.
- ***Kush e plotëson:*** komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm për nxënësit me aftësi të kufizuar (KIANAK), bazuar në informacionin e pranuar nga vlerësimi i KMDAR/ KMZA-së.
- ***Burimi i të dhënave:*** raporti i vlerësimit të KMDAR/KMZA-së, të dhënat mbi bazën e vlerësimit dhe identifikimit të nevojave arsimore e shoqërore të nxënësit, sipas klasifikimit ndërkombëtarë të funksionalitetit (KNF-FR).
- ***Kur hartohet:*** pas përpilimit të Diagnozes Funksionale të përcaktuar nga Komisioni përkatës KMDAR dhe përditësohet në mbarim të arsimit parashkollor; në mbarim të arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët.

- ***Përmbledhja e gjendjes aktuale tënxënësit dhe nevojate tij*** bazuar nëprofilin dinamik, funksional dhe rekomandimet e bëra nga komisioni DAR/ZA-së, për mbështetjen e tij. Në këtë pjesë, për secilin funksion të përcaktuar, jepet informacion se si aftësia e kufizuar e nxënësit ndikon në përfshirjen dhe ecjen përpara të tij në kurrikulën e përgjithshme dhe cilat janë mundësitë e zhvillimit në këtë fushë, bazuar në rekomandimet e komisionit të DAR/ZA-së. Mbështetur në këtë pikë, për secilin funksion parashikohen vështirësitë kryesore (nëse ka) dhe mundësitë për zhvillim.



Figura 2. Ndërveprimi midis përbërësve të KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Fuksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit).

Funksionet e trupit: janë funksione fiziologjike të sistemeve të trupit (përfshirë edhe funksionet psikologjike).
Këtu përfshihet informacion se si aftësia e kufizuar e nxënësit ndikon në përfshirjen dhe ecurinë e tij në kurrikulën e përgjithshme dhe mundësitë e zhvillimit në këtë fushë, bazuar në rekomandimet e komisionit të DAR/ZA-së.

Struktura trupore:janë pjesët anatomike të trupit si p.sh. organet, gjymtyrët dhe/ose pjesë të tyre.
Këtu përfshihet informacion se si aftësia e kufizuar e nxënësit ndikon në përfshirjen dhe ecurinë e tij në kurrikulën e përgjithshme dhe mundësitë e zhvillimit në këtë fushë, bazuar në rekomandimet e komisionit të DAR/ZA-së.

Veprimtaritë dhe pjesëmarrja: veprimtaria është kryerja e një detyre ose veprimi nga një individ, kurse pjesëmarrja është përfshirja në një situatë jetësore.
Këtu përfshihet informacion se si aftësia e kufizuar e nxënësit ndikon në përfshirjen dhe ecurinë e tij në kurrikulën e përgjithshme dhe mundësitë e zhvillimit në këtë fushë, bazuar në rekomandimet e komisionit të DAR/ZA-së.

Faktorët mjedisorë: përfshijnë mjedisin fizik, social dhe të sjelljeve, në të cilin njerëzit jetojnë jetën e tyre. Këtu përfshihen: 1) produktet dhe teknologjia; 2) mjedisi natyror dhe ndryshimet mjedisore të bëra nga njeriu; 3) marrëdhëniet dhe mbështetja/et shoqërore; 4) qëndrimet; 5) shërbimet, sistemet dhe politikat dhe si këta faktorë ndikojnë në arritjet e nxënësit në shkollë.
Këtu përfshihet informacioni se si aftësia e kufizuar e nxënësit ndikon në përfshirjen dhe ecurinë e tij në kurrikulën e përgjithshme dhe mundësitë e zhvillimit në këtë fushë, bazuar në rekomandimet e komisionit të DAR/ZA-së.

Shënim: Kjo pjesë plotësohet vetëm nëse nxënësit i është bërë një identifikim i nevojave të tij bazuar në KNF-FR.

PJESA B

PLANI EDUKATIV INDIVIDUAL (PEI)

B.1. ZHVILLIMI I NXËNËSIT NË FUSHA SPECIFIKE

Në këtë pjesë jepet një përmbledhje e përshkrimit të gjendjes aktuale të nxënësit në bazë të fushave të zhvillimit të tij. Kjo pjesë plotësohet nga **punonjësi i shërbimit psiko-social**. Këto fusha janë:

- ***Fusha e zhvillimit shqisor - motorik***
  p.sh. shkathtësitë e mëdha dhe të imta motorike, ekuilibri, koordinimi (sy-dorë), ritmi, tonusi i muskujve, lëvizja etj.
- ***Fusha e zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit***
  p.sh. komunikimi verbal (gjuha, të folurit, shenjat, të shprehurit, fjalori, leximi) dhe joverbal (shkrimi, gjuha e shenjave, simboleve, gjestet, gjuha trupore) etj.
- ***Fusha e zhvillimit social – emocional***
  p.sh. shkathtësitë shoqërore dhe shkathtësitë për bashkëpunim, të shprehurit, identifikimi dhe menaxhimi i ndjenjave, vetëmenaxhimi etj.
- ***Fusha e zhvillimit njohës***
  p.sh. përdorimi aktiv i shqisave, përzgjedhja, kategorizimi, zgjidhja e problemeve, të kuptuarit e arsyes - pasojës, të menduarit, krijueshmërisë etj.
- ***Fusha e aftësive për jetën dhe autonominë personale***
  p.sh. pjesëmarrja aktive në mjedisin që e rrethon, niveli i nismës, niveli i pavarësisë, shëndeti, siguria, shkathtësitë për jetën, veprimtaritë e kohës së lirë, etj.

B.2. REZULTATET E PRITSHME TË FËMIJËS/NXËNËSIT, BAZUAR NË 5 FUSHAT E ZHVILLIMIT

Mësimdhënia përmes fushave të veprimtarive mund të organizohet për fëmijët e moshës parashkollore. Po ashtu edhe kur mësimdhënia nuk mund të organizohet sipas lëndëve mësimore për fëmijët me AK të rënda ose të shumëfishta, në këto raste procesi edukativ-mësimor mund të organizohet sipas fushave të veprimtarive, si më sipër.
Fushat e veprimtarive janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe zhvillimi i njërës ndërlidhet edhe në zhvillimin e tjetrës.
Për disa fëmijë mund të jetë e arsyeshme që të organizohet procesi edukativo-mësimor pjesërisht sipas lëndëve të (individualizuara), e pjesërisht sipas fushave të veprimtarive.
Fëmija mund të aftësohet në një ose më shumë fusha veprimtarish, gjithmonë duke u bazuar në nevojat individuale të tij. Për secilën fushë të veprimtarive duhet të specifikohet:

- **Rezultatet maksimale dhe minimale të pritshme**. Nëse pritshmëritë janë arritur, duhet të përcaktohen pritshmëri të reja për fushat e zhvillimit dhe nëse nuk janë arritur, duhet të rivlerësohen dhe riformulohen të zbërthyera në elemente më të thjeshta.

- **Strategjitë dhe metodat e mësimdhënies**. **Strategjitë dhe metodat** që përdoren, mbajnë parasysh jo vetëm elemente që do të zbatohen në shtëpi dhe në shkollë, por edhe mundësitë për të zbatuar këto metoda. Te **mjetet e punës** përshkruhen të gjitha materialet didaktike që përdoren në klasë me fëmijët në arritjen e objektivave, p.sh. përdorimin e mjeteve teknike, teknologjike, mjetet ndihmëse, zmadhuesit, fotografitë, ilustrimet, lojërat logjike etj.
- **Mbështetja shtesë (burimet njerëzore).** Këtu përshkruhen të gjitha shërbimet që merr fëmija gjatë procesit mësimor si: mbështetja nga mësuesi ndihmës, mësuesi i klasës, ndihmësi personal i fëmijës (nëse ka) , prindi, ndihma nga bashkëmoshatarët ose më të rritur etj.

Në bazë të ndërhyrjeve që bën, parashikohen edhe **metodat e vlerësimit** të vlefshmërisë të ndërhyrjes. Vlerësimi i fushës së veprimtarive duhet të bëhet në bazë të synimeve/elementeve të caktuara për atë fushë të veprimtarive. Vlerësimi duhet të bëhet nga të gjithë personat që kanë punuar me fëmijën në zhvillimin e asaj fushe veprimtarish. Është me rëndësi që në vlerësim të përfshihen edhe prindërit, sepse ata sjellin informacion të rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës. Vëzhgimi i prindërve bazohet në skeda të hartuara dhe të miratuara nga komisioni me bazë institucioni arsimor, modelet e të cilave i bashkangjiten planit PEI.
Fëmija mund të përfshihet në vlerësim aq sa të jetë e mundur. Vlerësimi duhet të jetë me shkrim dhe përshkrues, duke mbuluar të gjitha elementet që përfshijnë fushat e veprimtarive.

B.3. LËNDËT OSE PROGRAMET ALTERNATIVE NË TË CILAT DO TË ZBATOHET PEI

Mbështetur në tabelën ku përfshihen të gjitha lëndët që parashikon kurrikula, identifikohet se në cilën lëndë do të ndiqet një **program i ndryshuar**[6] nga programi i përgjithshëm për pjesën tjetër të klasës, apo do të **përshtatet**[7] programi i përgjithshëm i klasës në elemente specifike sipas nevojave të nxënësit, si dhe të shihet mundësia për të zbatuar një **program alternativ**[8] që ndërtohet mbi nevojat e nxënësit, pa marrë parasysh programin e përgjithshëm. (p.sh. veprimtari praktike që lidhen me interesin e nxënësit dhe zhvillimin e aftësive praktike për jetën).
Për secilin rast, në kolonën përkatëse, mësuesi jep sqarime të veçanta në mënyrë të përmbledhur.

B.4. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PËRPARIMIT TË NXËNËSIT

Komisioni i shkollës për vlerësimin e nxënësit me AK/VN , mblidhet në fund të vitit shkollor për të bërë vlerësimin e nxënësit në bazë të rezultateve vjetore të arritura prej këtij të fundit, në prani të prindit/kujdestarit të nxënësit.
Në këtë seksion, duke u bazuar në *rezultatet e pritshme vjetore* të përcaktuara për secilën fushë dhe duke i krahasuar me *rezultatet e arritura*, kërkohet të vendoset për secilin nivel (maksimal dhe minimal) vlerësimi me notë sipas kritereve të përcaktuara në Udhëzimin 34/2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për vlerësimin e kurrikulës me kompetenca.

6. Mbajmë parasysh se kurrikula e re ofron mundësi dhe hapësirë për mësuesin për fleksibilitet dhe lirshmëri nga ana e tij. (Parashikuar në Kornizën kurrikulare të APU, MAS, 2014)

7. Po ashtu kurrikula e re parashikon lirshmëri nga ana e mësuesit për përshtatje të programit mësimor bazuar në nevojat dhe ritmet individuale të nxënësve.

7. Të mbahet parasysh puna krijuese që mund të realizojë secili mësues apo grup mësuesish në varësi të kushteve dhe mjeteve.

Në lidhje me këtë vlerësim, mund të shkruhen komente të cilat kërkohen të merren parasysh apo lehtësojnë të kuptuarit e arsyetimit që ka drejtuar vlerësimin e nxënësit.
Gjithashtu, komisioni, me vendim të përbashkët, arrin në përfundimin për vlerësimin e përgjithshëm, duke llogaritur notën mesatare për arritjet vjetore të nxënësit.
Anëtarët e komisionit të cilët marrin pjesë në vlerësimin e përgjithshëm të nxënësit, vendosin emrat në hapësirën përkatëse. Gjithashtu prindi/kujdestari i nxënësit vendos emrin në hapësirën përkatëse dhe shpreh mendimet e veta mbi vlerësimin e arritur në këtë seancë. Prindi ka të drejtë të sjellë informacione të nevojshme që mendon se duhet të merren parasysh për vlerësimin e fëmijës së .tij.

PJESA C

PLANI DIDAKTIK I PERSONALIZUAR (PDP)

Si të kuptojmë PDP në kontekstin e PEI-t.
Plani PEI është i nevojshëm të hartohet për të gjithë nxënësit që kanë aftësi të kufizuar dhe për të cilët është rekomanduar nga KMDAR/KMZA, ndërsa PDP-ja është i nevojshëm për të gjithë nxënësit që shfaqin çrregullime specifike të të nxënit (përcaktuar sipas DSM-V) dhe, për të cilin, parashikohen të përdoren mjete ndihmëse dhe masa përjashtuese, si dhe kur nxënësi shfaq zhvillim përkeqësues në të nxënë dhe në marrëdhënie me të tjerët.
PDP-ja rekomandohet në ato raste kur është diagnostikuar një çrregullim klinik dhe rendimenti i nxënësit nuk përmirësohet pas ndërhyrjeve dhe përshtatjeve të ndryshme të bëra nga mësuesi të veprimtarive didaktike të përditshme.
Gjithashtu PDP-ja mund të hartohet, nëse KIANAK-u e vlerëson të nevojshme, edhe për nxënësit që shfaqin nevoja të tjera edukative (shiko tabelën 1).

KUJDES

Individualizimi i të nxënit vendos objektiva të përbashkëta njohëse për të gjithë klasën, duke përshtatur metodologjitë dhe strategjitë e ndërhyrjeve në funksion të karakteristikave individuale të çdo nxënësi.

Personalizimi parashikon objektiva të ndryshme njohëse dhe kërkon t'i japë çdo nxënësi mundësinë për të zhvilluar në maksimumin e mundshëm aftësitë e tij.

PLAN

Objektiva për të arritur, të formalizuar në terma zbatues dhe specifikë;
Koha që parashikohet të arrihen rezultatet e projektuara;
Hapat që parashikohen të ndiqen;
Strategjitë dhe **materialet** që do të përdoren për të konkretizuar hapat e planifikuara;
Kriteret që do të merren parasysh për verifikimin e vlefshmërisë së ndërhyrjeve të zhvilluara

DIDAKTIK

Plani është **"didaktik",** sepse projektohet në **dy nivele**, atë **përmbajtësor** (disiplinat e ndryshme, aftësitë bazë akademike, njohuritë dhe njohuritë proceduriale) dhe atë **metodologjik** (nga mësimdhënia e drejtpërdrejtë, në të nxënët zbulues, bashkëveprues, TIK, përshtatja e materialeve, etj.). Gjithashtu nuk duhet të harrohen **përmasat e ndërmjetme** (motivimi, shoqërizimi, etj.) që mbështesin proceset e të nxënit të nxënësit.

I PERSONALIZUAR

Plani është i **"personalizuar"**, pra i ndërtuar, duke iu referuar nevojave edukative dhe profilit funksional të nxënësit, duke konsideruar element të kontekstit klasë ku bën pjesë nxënësi. Me fjalë të tjera, duhet gjetur mënyra më e përshtatshme për nxënësin, duke pasur parasysh pikat e forta dhe ato të dobëta, por edhe mundësitë, mbështetjet dhe pengesat që shfaqen në jetën e përditshme.

C.1. KUADRI INFORMUES

Plani Didaktik i Personalizuar (PDP) përmban të dhënat e nxënësit: emër, mbiemër dhe datëlindjen, kodin e nxënësit që përkon me kodin e dosjes personale të tij, mësuesin përgjegjës që do të plotësojë planin, mësuesin ndihmës (kur ka), klasën që frekuenton, diagnozën e përcaktuar (nëse ka një të tillë), data, specialisti apo struktura që ka nxjerrë diagnozën.

Ndërhyrjet paraprake apo paralele me frekuentimin e shkollës, mbajnë parasysh çdo ndërhyrje të kryer qoftë në aspektin edukativ, ashtu edhe në atë aftësues/riaftësues të nxënësit, duke specifikuar personin që ka kryer ndërhyrjen, datën, periudhën e frekuentimit dhe metodën e ndjekur *(të dhënat nxirren nga dokumentacioni i paraqitur nga familjarët apo/edhe nga biseda me familjarët) si dhe nga plani PEI i nxënësit i përgatitur nga KIANAK.*

Shkollimi i mëparshëm parashikon përshkrimin e frekuentimit, duke përcaktuar problematikat që e kanë shoqëruar atë, komentet e mësuesve të dhëna në shkollimin paraprak dhe/ose vlerësimet e ndryshme të sjella prej tyre. (*të dhënat nxirren nga dokumentacioni i paraqitur nga familjarët apo/edhe nga biseda me familjarët*)

Marrëdhënia shkollë-familje mban parasysh cilësinë e bashkëpunimit me pjesëtarët e familjes dhe faktin se cili është familjari që kontakton më shpesh me shkollën (merr pjesë më shumë në takimet e organizuara).(*kjo e dhënë përcaktohet nga vetë mësuesi)*

Konteksti familjar parashikon vështirësitë që has nxënësi në shtëpi dhe fushën përkatëse të vështirësive, si dhe masat e marra për menaxhimin e tyre në kohën kur ato shfaqen. (*të dhënat nxirren nga kontakti me prindërit/kujdestari ligjor*)

Aspekti social –emocional dhe motivues plotësohet bazuar në pikat orientuese të paraqitura. Këtu përshkruhen marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, qasja ndaj angazhimeve shkollore (pavarësia në detyrat e shtëpisë), aftësitë organizuese dhe sa i ndërgjegjshëm është për vështirësitë e veta (*të dhënat nxirren nga bisedat dhe takimet me prindërit/kujdestari ligjor*).

C.2. FUNKSIONIMI I AFTËSIVE BAZË (SHKRIM, LEXIM DHE LLOGARITJE)

Te tri aftësitë e sjella, (lexim–shkrim-llogaritje), janë përcaktuar elemente bazë dhe karakterizuese për vlerësimin e përvetësimit të secilës aftësi. ***Mësuesi*** duhet të specifikojë, duke iu referuar diagnozës apo nga vëzhgimet e kryera në klasë, nëse nxënësi shfaq apo jo vështirësi për secilin element karakterizues të aftësisë bazë. Nëse rezulton nga diagnoza/vlerësimi i specialistit apo nga vëzhgimet në klasë që nxënësi ka vështirësi në një element karakterizues për aftësinë specifike, atëhere në kolonën pasuese vendoset një shenjë ***X*** në kutinë që tregon se është "pikë e dobët" për nxënësin dhe përshkrimi specifik i vështirësisë do të jepet, duke iu referuar diagnozës apo vëzhgimit në kolonat përkatëse.

Elementë thelbësore në proceset e të nxënit

Në këtë tabelë merren në shqyrtim elemente të tjera që luajnë një rol thelbësor në procesin e të nxënit, siç janë *kujtesa, vëmendja, fuksionet ekzekutive dhe metodat e studimit.* ***Mësuesi*** , duke iu referuar diagnozës/vlerësimit të specialistit apo vëzhgimeve të kryera në klasë, plotëson për secilën prej tyre, nëse nxënësi shfaq apo jo vështirësi (duke vendosur në kolonën që pason *AFTËSITË,* shenjën ***X*** në kutitë përkatëse: ***PF –*** *pikë e fortë;* ***PD –*** *pikë e dobët)* dhe duke dhënë përshkrimin e detajuar të elementeve kritike apo të aftësive të shfaqura. Është e rëndësishme që të jepen edhe elementet e përvetësuara për secilën aftësi (të identifikuara si *pika të forta)*, në mënyrë të tillë që të përdoren si pika mbështetjeje për planifikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies apo të ndërhyrjeve specifike etj.

Të tjera

Duke iu referuar edhe informacioneve të sjella në planin PEI, në këtë seksion, janë sjellë disa elemente si: (*marrëdhëniet shoqërore; respektimi i rregullave; vetërregullimi emotiv; bilinguizmi; pavarësia personale dhe kujdesi për veten*), të cilat ndikojnë në qasjen e nxënësit ndaj mësimdhënies dhe të nxënit. Mësuesi, duke iu referuar diagnozës/ vlerësimit të specialistit apo sjelljeve të vëzhguara në klasë, specifikon (duke treguar me një shenjë ***X*** në kutitë përkatëse: ***PF –*** *pikë e fortë;* ***PD –*** *pikë e dobët*), nëse nxënësi shfaq apo jo vështirësi për të nxënë suksesshëm dhe për t'u përfshirë në veprimtari si bashkëmoshatarët apo elementet e përmendura krijojnë disavantazh te nxënësi, duke përshkruar në kolonat që ndjekin karakteristikat që e klasifikojnë si *pikë të fortë apo të dobët*.

Këto elemente do të ndihmojnë mësuesin në përzgjedhjen apo ndërtimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, organizimin e të gjitha veprimtarive të planifikuara për grupin klasë, si dhe zgjedhjen e mjeteve të nevojshme që do të përdoren për të arritur rezultatet e pritshme.

C.3. STRATEGJI METODOLOGJIKE DHE DIDAKTIKE

Në këtë pjesë mësuesi specifikon elementet e përshtatshme, duke përfshirë:

- *Modele organizimi* –të cilat përshkruajnë masat që do të merren për organizimin e burimeve njerëzore, të materialeve didaktike, integrimi i PDP-ve që përfshihen në të njëjtën klasë dhe programit kurrikular. Është e rëndësishme që në këtë nivel të mendohet, duke iu referuar elementit të përtshtatshëm, "bashkëjetesës" të disa PDP-ve të hartuara për nxënës me vështirësi në të nxënë apo për nxënës me aftësi të kufizuar.
- *Menaxhimi i mësimdhënies* – i cili përshkruan aspekte të mësimdhënies, të cilat mendohen të personalizohen dhe/apo individualizohen duke nënkuptuar menaxhimin e kohës, stilet e qasjes në klasë, strategjitë e përdorura të mësimdhënies, strategjitë e zgjedhura të komunikimit, duke iu referuar stileve të të nxënit të nxënësve, kontrollit të marrëdhënieve me nxënësit, etj. Zgjedhjet e bëra në elementet e sapopërmendura, duhet të jenë të ndjeshme ndaj profilit të funksionimit të nxënësit dhe stileve konjitive të tij.
- *Përshtatjet* –të cilat përshkruajnë të gjitha ndryshimet që mendohen të bëhen në mjedisin fizik (vendosja e bankave, përdorimi i tyre, etj.); të mjeteve didaktike apo dhe atyre ndihmëse (librat, fletoret, planet, makinë llogaritëse, kompjuter, mjete te tjera teknologjike etj.); të kohës në dispozicion për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme, apo renditja e veprimtarive sipas kohës që nevojitet për secilën prej tyre, pushimet ndërmjetëse, etj.
- *Strategji dhe teknika ndërhyrjeje –të cilat* përshkruajnë strategji ndërhyrjeje që do të ndërmerren si në planin e sjelljes, ashtu dhe në atë të të nxënit, apo në aspekte të tjera ku mendohet të planifikohen ndërhyrje të strukturuara.
- *Mjete ndihmëse – ku* listohen mjetet plotësuese që mendohet të përdoren gjatë mësimdhënies dhe të nxënit, si dhe mjetet të tjera ndihmëse që përdoren zakonisht si: hartat, skemat etj. Në përdorimin e mjeteve ndihmëse plotësuese, duhet të kihen parasysh dy kritere:
  - **a)** mësuesi të mundohet të zgjedhë mjete të cilat përdoren nga e gjithë klasa dhe jo vetëm nga nxënësi për të cilin është hartuar PDP-ja;
  - **b)** këto mjete të përdoren me qëllim mënjanimin e tyre (aq sa është e mundur), duke synuar kalimin e nxënësit nga varësia në pavarësi.
- *Kritere dhe metoda verifikimi* –të cilat përshkruajnë ato kritere që parashikon mësuesi për vlerësimin e të nxënit, por edhe të vlefshmërisë së vetë PDP-së, bazuar në mundësitë për arritje të nxënësit dhe duke iu përshtatur nevojave të tij.

C.4. PLAN I VEPRIMIT PËR LËNDËN

Në këtë pjesë mësuesi specifikon elementet e përshtatshëm për secilën lëndë ku është menduar të hartohet një PDP. Mësuesi i lëndës plotëson të dhënat siç paraqiten në tabelën përkatëse.
Vendoset titulli i lëndës, emri dhe mbiemri i mësuesit të lëndës si dhe i mësuesit ndihmës (nëse ka).
Te hapësira e përcaktuar "*Nivelit aktual të arritjeve",* mësuesi duhet të vlerësojë me teste shkollore të ndërtuara posaçërisht dhe të parashikuara në PDP, për të matur nivelin e arritjeve që paraqet fëmija përpara së të punohet me PDP, për ta krahasuar më pas me nivelin e arritur pas një periudhe kohe të caktuar që është punuar me PDP.
E rëndësishme është që gjatë vlerësimit të nxënësit, të mbahen në kontroll elemente të jashtme apo të brendshme, që mund të ndikojnë në përformancën e nxënësit në çastin e vlerësimit të tij (elemente të mjedisit që mund të prishin vëmendjen e fëmijës apo gjendjes fiziologjike-psikologjike të fëmijës, të cilat mund të ndikojnë te ky i fundit).
Te rezultate të pritshme të të nxënit, mësuesi duhet të specifikojë rezultatet e pritshme për periudhën tre mujore, për lëndën përkatëse,për të cilën hartohet PDP-ja.
Gjithashtu, mësuesi përshkruan në mënyrë të përmbledhur strategjitë dhe *metodologjitë didaktike; mjetet ndihmëse; masat përjashtuese dhe metodat e vlerësimit (duke specifikuar dhe personin përgjegjës për monitorimin e arritjeve të nxënësit),*që do të zbatohen gjatë zhvillimit të lëndës specifike. Vlerësimi i arritjeve të rezultateve të pritshme, kërkohet të specifikohet nëse rezultatet e pritshme janë arritur plotësisht, në mënyrë të pjesshme apo nuk janë arritur, duke vendosur shenjën ***X*** në kutinë përkatëse dhe duke dhënë komentet e nevojshme që sqarojnë përfundimet e nxjerra.

Strategji dhe metodologji didaktike

- Vlerësimi dhe promovimi i kodeve alternative gjuhësore nga ai ato të shkruara (gjuha ikonografike, gjuha verbale), duke përdorur ndërmjetës didaktikë si imazhet, vizatimet dhe përmbledhjet e zëshme;
- Përdorimi i skemave dhe hartave konceptuale;
- Nxitja e të nxënit nëpërmjet zhvillimit të përvojave personale apo në grup dhe didaktikës në laborator;
- Promovimi i proceseve metakonjitive për të nxitur nxënësin drejt vetëkontrollit dhe vetëvlerësimit të proceseve të të nxënit të zbatuara prej tij;
- Ndërtimi dhe organizimi i didaktikës në grupe të vogla dhe nxitja e të nxënit dhe tutorimit mes të barabartëve;
- Promovimi i të nxënit bashkëpunues.

Këto strategji vihen në përputhje me lëndën përkatëse.

Masa përjashtuese – janë ndërhyrje të cilat i lejojnë nxënësit të mos kryejnë disa detyra apo veprimtari, të cilat, për shkak të vështirësisë që nxënësi shfaq, rezultojnë shumë të vështira dhe nuk ndihmojnë të nxënët. Këto masa mund të përdoren si gjatë veprimtarisë didaktike, ashtu edhe në hartimin e testeve apo mjeteve vlerësuese të rezultateve të të nxënit.
Masat përjashtuese mund të jenë:

- leximi me zë të lartë;
- mbajtja e shënimeve;
- koha standarde për zhvillimin e detyrave të ndryshme (i jepet më shumë kohë në dispozicion);
- të kopjuarit nga dërrasa ose libri
- diktimet e teksteve apo të shënimeve;
- ngarkesa e tepërt me detyra në shtëpi;
- testime në distancë kohe të afërt;

- marrja në pyetje pa paralajmërim;
- memorizimi i tabelave, formulave, përkufizimeve;
- ndjekja e mësimit në klasë; etj.

Mjetet ndihmëse – janë ato të cilat nxënësi mund t'i përdorë dhe i lejojnë të plotësojë mangësitë funksionale të shkaktuara nga çrregullimi. Këto mjete mund ta ndihmojnë nxënësin në procedura mekanike, duke i mundësuar të drejtojë vëmendjen në detyra konjitive dhe të ndihmojë dorëzimin më të shpejtë të detyrës dhe korrektësinë e saj. Sipas disiplinave dhe rasteve, këto mjete mund të jenë:

- Tabela e alfabetit;
- Renditja në rresht e numrave (numëratori);
- Tabela e Pitagorës;
- Vizatimi i harkut kohor:
- Tabela e masave dhe formulave gjeometrike;
- Modele formularësh ndihmës, skema, harta konceptuale të njësive të të nxënit;
- Kompjuter me program të videoshkrimit, korrigjues ortografikë dhe sinteza vokale;
- Stampa dhe skanera;
- Makina llogaritëse;
- Regjistrues zëri dhe burime audio (libra audio dhe digjitalë);
- Software didaktikë specifikë.

Vlerësimi

- Parashikimi dhe programimi i verifikimeve në mënyrë të përshkallëzuar.
- Programimi me nxënësin i elementeve të verifikimit/vlerësimit.
- Të parashikohen më shumë verifikime nëpërmjet komunikimit verbal, sesa detyrave me shkrim.
- Vlerësimi i orientuar më shumë te përmbajtja sesa te forma.
- Përdorimi i mjeteve dhe lehtësuesve didaktikë në provat me shkrim apo/dhe me gojë.
- Të parashikohet dhe të jepet më shumë kohë gjatë zbatimit të provave

C.5. BASHKËPUNIMI ME FAMILJEN

Kjo pjesë ka për qëllim dakordësimin dhe vazhdimësinë e ndërhyrjeve të planifikuara në shkollë me nxënësin dhe planifikimin e angazhimit të tij në shtëpi, duke siguruar mbështetje nga familjarët apo të afërm të tjerë. Mësuesi, gjatë takimit me prindërit/ kujdestarët ligjorë të nxënësit, merr të dhëna dhe i sjell në tabelën e përcaktuar për këtë informacion. Gjithashtu kërkohet informacion edhe mbi mjetet që mundet të ketë fëmija në shtëpi, të cilat mund ta ndihmojnë në proceset e të nxënit.
Me familjarët/kujdestarët ligjorë të nxënësit, bihet dakord për mënyra të përshtatshme monitorimi të të nxënit të tij në shtëpi. Gjithashtu kërkohet nga familjarët/ kujdestarët ligjorë të fëmijës të shprehin gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në veprimtari të programuara nga shkolla më natyra të ndryshme (grupe studimi mbas shkolle, veprimtari kulturore etj.)

PJESA D

PROJEKTI PËR JETËN (PPJ)

- **Përse shërben**: për të lehtësuar kalimin e nxënësit nga një kontekst në tjetrin dhe nga një nivel arsimor në tjetrin.
- **Kush e plotëson**: Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm për nxënësit me aftësi të kufizuar **(KIANAK)**, i cili mbulon nxënësin për momentin, në bashkëpunim me **KIANAK-un** (ku nxënësi do transferohet ose personat e tjerë kujdestarë/përgjegjës në kontekstin ku nxënësi do të transferohet), koordinatori i transferimit, zyra e qeverisjes vendore përgjegjëse për çështjet sociale.
- **Kur plotësohet**: Plotësohet *vetëm në rastet* kur ndodh:
  a) Kalimi i nxënësit nga një nivel arsimimi në nivelin pasues.
  b) Transferimi paralel nga një zonë/shkollë në një tjetër.
  c) Kalimi, nga shkolla në struktura ku do të punësohet, apo do të kryejë aftësimin praktik/stazhin.
  d) Kalimi nga shkolla në të jetuarit e pavarur dhe aktiv në komunitet.
  Plotësimi i kësaj pjese bëhet në varësi të rasteve që paraqiten, të paktën gjashtë muaj para se të ndodhë kalimi i nxënësit.
- **Burimi i të dhënave**: Informacionet nga pjesët A, B, C, prindi, specialistët, punonjësi social, ofruesit e shërbimeve, etj.
- **Informacioni që përmban**: plan ndërhyrjeje me objektiva specifike të ndërtuara me qëllim për të përgatitur nxënësin për kalimin e parashikuar, parashikimin e ndërhyrjeve të nevojshme për eliminimin e pengesave të ndryshme dhe ndërtimin e një klime miqësore në strukturën pritëse.

D.1. PLANIFIKIMI I KALIMIT TË NXËNËSIT NGA NJË KONTEKST NË TJETRIN

Kjo ndarje përfshin informacion mbi identitetin, fazën në të cilën ndodhet nxënësi dhe saktësimin se për ku përgatitet të kalojë ai. Në varësi të kësaj të fundit, në tabelën e ndarjes **D.1**, detajohen gjithashtu nevojat dhe drejt cilave interesa, fusha, veprimtari të mundshme, do adresohemi gjatë vitit parapërgatitor të kalimit, si dhe nga ku saktësohen objektivat specifike që më tej, detajohen në ndarjen **D.2**.

D.2. OBJEKTIVAT SPECIFIKE PËR LEHTËSIMIN E KALIMIT TË NXËNËSIT NGA NJË KONTEKST NË TJETRIN

Objektivat specifike në tabelën **D.2.1** burojnë nga adresimi i detajuar i interesave, fushave, veprimtarive të përcaktuara në ndarjen **D.1.** e që zhvillohen përgjatë vitit të fundit si parapërgatitje (gjithsesi edhe si pjesë organike e PEI-t). Tabela **D.2.2.** që pason objektivat specifike, përpiqet të përcaktojë hapat që do të ndërmerren kryesisht për periudhën kur afrohet koha e kalimit dhe pas kalimit.

Përcaktimi i veprimeve, dokumentacionit përkatës përcjellës e pritës, si dhe personave përgjegjës dhe afateve, lehtëson dhënien e mbështetjes që nxënësit i nevojitet. Fakti që kemi të bëjmë me kalimin nga një mjedis në tjetrin, dikton nevojën e përfshirjes në planifikim dhe zbatim të aktorëve të të dy anëve të kësaj "ure" që duhet ndërtuar.

Emri i pjesëmarrësve

Plani i tranzicionit duhet të nënshkruhet nga prindërit, mësuesi dhe drejtori i shkollës dërguese si dhe mësuesi dhe drejtori i shkollës marrëse.

Bibliography

Ministry of Education, Ontario CA. (2004). The individual Education Plan (IEP), A resource Guide. Ontario. Gjetur Nëntor 08, 2016, nga http://www.edu.gov.on.ca/eng/general/elemsec/speced/guide/resource/

Cornoldi, C. (2007). *Difficoltà e disturbi dell'apprendimento.* Bologna: Il Mulino.

Erikson (Re.). (2013). *Dislessie e altri DSA a scuola. Strategie efficaci per gli insegnanti.* Trento: Erikson.

IZHA; MAS. (2016, Shtator-Tetor). Nivelet e arritjeve së kompetencave. Gjetur Prill 04, 2017, nga http://izha.edu.al/nivelet-e-arritjeve/

MAS. (2014). Korniza Kurrikulare e Arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë. Tiranë. Gjetur Prill 04, 2017, nga http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Korniza-Kurrikulare.pdf

MAS. (2014). Ligji 93 Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara. *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 135*, fv. 6159-6164.

MASH. (2012). Ligji 69 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë* , fv. 4402-4426.

MASH. (2013). *Dispozitat Normative Për Sistemin Arsimor Shqiptar.* Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Save the Children. (2013). *Arsimi Gjithëpërfshirës në Shqipëri. Studim analitik.* Tiranë: Save the Children.

Stella, G., Cornoldi, C., Lucangeli, D., & Fedeli, D. (2016). *Il PDP. Come e cosa fare. .* Milano: Giunti edu.

UN General Assembly. (2007, Janar 24). Convention on the Rights of Persons with Disabilities : resolution / adopted by the General Assembly. Gjetur Prill 04, 2017, nga https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N06/500/79/PDF/N0650079.pdf?OpenElement

UN General Assembly. (1989, Nëntor 20). Convention on the Rights of the Child. United Nations, Treaty Series. *1577* . Gjetur Prill 4, 2017, nga https://documents-dds-ny.un.org/doc/RESOLUTION/GEN/NR0/547/84/IMG/NR054784.pdf?OpenElement

Xhamo, M., Ndrio, M., Poni, M., Koka, Z., Goci, R., & Çela, R. (2010). *Një shkollë për të gjithë.* Tiranë: Save the Children.

Shtojca

Përcaktimi i vendit ku do të vijojë mësimin

Vendi	Orar i plotë	Orar i pjesshëm	Lëndë	Emri i mësuesit
Klasë e rregullt				
Klasë e bashkëngjitur				
Qendër burimore				
Institucion parashkollor				
Të tjera				

Shërbimet brenda institucioneve edukativo-arsimore:

Shërbimi	Emri dhe mbiemri	Kontakti (Nr. Telefonit / e-mail)	Data e raportit
Psikologu			
Pediatri			
Mësuesi			
Asistenti i fëmijës			
Logopedisti			
Punonjësi i shërbimit psiko -social			
Të tjerë			

Shërbimet jashtë institucioneve edukativo-arsimore

Shërbimi	Emri dhe mbiemri	Kontakti (Nr. telefonit / e-mail)	Data e raportit

Planifikimi dhe rishikimi i PEI-t

Data e planifikimit	Rishikimi i parë	E kryer	Rishikimi i dytë	E kryer

Pyetësori i verifikimit të PDP-së (përshtatur nga Stella, Cornoldi, Lucangeli, & Fedeli, 2016, f. 37). Përdoret nga mësuesi për vetëvlerësim nëse janë ndjekur të gjithë hapat gjatë hartimit dhe zbatimit të PDP-së.

Plani	
Janë përcaktuar qartësisht **objektivat** në planin e të nxënit dhe të marrëdhënieve?	☐
Janë artikuluar **hapat** e procesit?	☐
Është përcaktuar **koha** që mendohet të nevojitet për arritjet afatmesme dhe ato përfundimtare?	☐
Janë përcaktuar **strategjitë** që do të përdoren (masat përjashtuese dhe mjetet ndihmëse)?	☐
Janë qartësuar **kriteret e vlerësimit** të objektivave?	☐
Didaktik	
Qartësohen objektivat dhe ndërhyrjet në **çdo disiplinë**?	☐
Qartësohen objektivat dhe ndërhyrjet për **aftësitë bazë** (lexim, shkrim dhe llogaritje)	☐
Qartësohen objektivat dhe ndërhyrjet për **aftësitë trasversale dhe sociale** (metodat e studimit, motivimi, etj.)?	☐
